

PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Mallra

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: ‘Blerje uniforma dhe veshje të tjera speciale’

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): Veshjeve mbrojtëse dhe sigurie- 35113400-3;

1. Fondi limit/vlera e pritshme e kontratës: **25,036,683** (njëzet e pesë milion e tridhjetë e gjashtë mijë e gjashtëqind e tetëdhjetë e tre) lekë pa tvsh

Burimi i financimit: Burimi i financimit: vënë në dispozicion nga të ardhurat e Bashkisë Tiranë me anë të VKB-së Nr. 100 datë 18.12.2025 “Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2026-2028 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë Tiranë për vitin 2026”.

Kohëzgjatja e Marrëveshjes Kuadër ose afati i zbatimit të kontratës: Brenda 80 ditëve kalendarike nga data e lidhjes së kontratës.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti kontraktor Bashkia Tiranë ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar.

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT PËR:

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 9;

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;

c. Formularin e Ofertës Ekonomike, sipas Shtojcës 1

d. Lista e çmimeve të artikujve sipas Shtojcës 3

Argumentimi: Kriteret e mësipërme janë vendosur në përputhje me Nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetdeklarimit” dhe Neni 83 “Sigurimi i ofertës”, të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, si dhe në mbështetje të nenit 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar: citojmë Neni 83 i LPP “Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël”, Neni 82, i LPP “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik”.

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Referuar pikës 1 të shtojcës 8, ofertuesi duhet të deklarojë se përmbush kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit. Këto kriteret duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 9.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 40, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", si dhe shtojcës 8 të DST-së.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

- 221** Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2023, 2024, 2025, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë **jo më e vogël se 40 % e vlerës së përlllogaritur së kontratës**, lëshuar nga autoriteti përkatës. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit/ vlera e pritshme e kontratës së përlllogaritur për lot, si dhe nenin 77, pika 3, të LPP, si dhe nenin 43, pika 2/c dhe pika 5, si dhe neni 55, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: "Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë:

Pika 2/a: dyfishin e vlerës së përlllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar;". Vlera e përlllogaritur është mbi kufirin e lartë monetar dhe për këtë arsye, vlera e xhiros minimale të kërkuar, është brenda kufirit të parashikuar në dispozitat ligjore të sipërcituara.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", si dhe në legjislacionin e fushës në fuqi, përkatësisht në Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklarave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike", si dhe në Udhëzimin e Ministrisë të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar.

2.2.2 Kopje të certifikuara të bilanceve të 3 (tri) viteve të fundit financiare (2023, 2024, 2025) të paraqitur në Autoritetet përkatëse Dega e Tatim Taksave të konfirmuara nga ky Autoritet si dhe të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar. (Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëse në dy balance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit).

Shënim: Akt Ekspertizë e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, duhet të paraqitet nga OE vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, germa b), të Ligjit nr. 10091, datë 05.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar", i ndryshuar, ku parashikohet se: "Detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, individuale apo të konsoliduara, përpara publikimit të tyre:

b) të gjitha njësitë ekonomike dhe grupet e njësive ekonomike, të cilat në mbyllje të periudhës kontabël, për dy vjet radhazi, tejkalojnë dy prej tre treguesve të mëposhtëm:

i. totali I aktiveve të bilancit në mbyllje të periudhës kontabël për katësearrinose e kalon shumë prej 50 000 000 (pesëdhjetë milionë) lekësh;

ii. shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumë prej 100 000 000 (njëqind milionë) lekësh;

iii. ka mesatarisht të paktën 50 (pesëdhjetë) të punësuar gjatë periudhës kontabël

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik". Neni 43, pika 4, të VKM nr. 285 "Nëse vlerësohet, autoriteti/enti kontraktor mund të kërkojë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilanci të tyre vjetore, për një periudhë maksimumi tre vitet e fundit financiare, që të tregojnë raportet, ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Nëse kërkohen një ose dy bilanci, kërkesa konsiderohet e përmbushur nëse në bilanci/et e kërkuara nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Nëse kërkohen bilanci të tre viteve të fundit, kërkesa konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilanci të njëpasnjëshme të kërkuara, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit." Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, është bërë bazuar në nenin 29, pika 1 të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat" i ndryshuar si dhe kërkesave të Ligjit nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare".

2.2.3. Vërtetim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2025 dhe për këstin përkatës të vitit 2026 sipas përcaktimeve të Ligjit Nr.9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", (i ndryshuar). Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoriteti përkatës sipas adresave të regjistruar sipas QKB.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar në nenin 77, pika 3, e LPP, nenin 43, pika 6, të VKM nr. 283, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" (i ndryshuar), si dhe ligjin nr.9920 datë 19.05.2008 "Për procedurat tatimore" i ndryshuar, neni 4, pika 2. gërma di dhe në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 "Për Sistemin e Taksave Vendore" i ndryshuar.

Ky kriter shërben për të garantuar AK se operatorët ekonomikë pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi kanë kapacitetet e duhura ekonomike dhe financiare si dhe janë të përshtatshëm për të kryer veprimtari profesionale. Referuar sa më sipër, Autoriteti Kontraktor gjykon se kriteri i vendosur lidhur me dorëzimin nga ana e operatorëve ekonomikë të deklaratës për shlyerjen e detyrimeve vendore për vitin 2025 sipas kësteve pranë bashkisëve ku operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij është në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi e konkretisht me ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 për "Sistemin e Taksave Vendore ndryshuar. Të gjithë subjektet që ushtrojnë veprimtari biznesi kanë detyrimin ligjor të regjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit për të bërë të identifikueshëm vendodhjen e aktivitetit të tyre dhe për t'iu nënshtuar pagesës së taksave vendore të parashikuara shprehimisht në këtë ligj.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Për të provuar përvojën e mëparshme, Operatorët ekonomik duhet të paraqesin dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë **jo më të vogël se 40% të vlerës së përlogaritur të kontratës, që prokurohet.**

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) Vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe/ose fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.
- b) Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenit 40/4, si dhe neni 55, pika 4/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, citohet: “Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë **jo më të madhe se 40% të vlerës së përllogaritur të kontratës**, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme është vendosur brenda kufirit të vlerës të përcaktuar në rregullat e prokurimit publik dhe i shërben AK për të treguar se ofertuesit me kapacitetet e tyre kanë realizuar kontrata të ngjashme me objektin që prokurohet, në vlerë jo më të vogël se 40 % të fondit limit, në afat, me cilësi dhe rrit besueshmërinë mbi përvojën që ka ofertuesi në treg. Përvoja e ngjashme konsiderohet si kriter thelbësor dhe si rrjedhim operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmi të tilla si referenca/fatura tatimore, për të provuar kryerjen e tyre qoftë me sektorin privat dhe atë publik.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë certifikatën ISO si më poshtë:

- 1- Çertifikatën e menaxhimit të cilësisë SSH/DIN/EN/CEI/UNI ISO 9001:2015 (e vlefshme) ose ekuivalente, e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

(Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, Operatorët ekonomik duhet të paraqesin Çertifikatën ISO ose ekuivalente, në bazë të zërave të marrë përsipër në marrëveshjen e bashkëpunimit).

Argumentim: Kërkesat e cilësisë të përcaktuara sipas pikës 10 gërma “a”- “b” janë vendosur në mbështetje të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 79, pika 1 ku citohet se: “Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë”, si dhe në zbatim të Neni 44, pika 1 dhe pika 3 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ku përcaktohet se: “Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit”.

Kërkesa për certifikim sipas standardeve ISO është në vetvete një garanci me teper për suksesin e projektit, në lidhje me cilësinë e produktit. Përmblotja e standartit ISO 9001 është thelbësore, dhe siguron menaxhimin e cilësisë së shërbimeve që kategorizohen në kontratë. Ky lloj certifikimi garanton Autoritetin Kontraktor se Operatori Ekonomik ka të implementuar një sistem menaxhimi të cilësisë për shërbimet e ofruara dhe zbatimin e kontratës në tërësi e rrjedhimisht dhe përmblotjen e saj sipas të gjitha standarteve të cilësisë. ISO 9001 parashikon një tërësi rregullash që garantojnë një bazë rreziku parandalues ndaj cilësisë dhe mbulon një gamë të gjerë të

çështjeveku përfshihen: angazhimi i lartë i menaxhimit për cilësi nga Operatori Ekonomik, fokusin e klientit përshtatshmërinë e burimeve të tij, kompetencën profesionalizmin e punonjësve, procesin e menaxhimit, planifikimin e cilësisë, dizenjimi i produkteve dhe shërbimet që ofron, garantimin e njëprocesi cilësor të furnizimit/shërbimit, sigurimin e konformitetit për shërbimet, proceset e tij për të zgjidhur ankesat e konsumatorëve, veprime korrigjuese, dhe një kërkesë për të nxitur përmirësimin. Kjo kërkesë, dëshmon se mbajtësi i saj garanton standardet ndërkombëtare të menaxhimit të cilësisë së ushtrimit të aktivitetit tregtar të tij.

Kërkesa për ISO 9001 është një kërkesë e domosdoshme për të garantuar realizimin me sukses të kontratës.

2.3.3 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për rezultatet e testimeve zyrtare (*Raporte testimi të materialeve përbërëse të produkteve të uniformës për artikullin mostër*), që të vërtetojë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike, të lëshuara nga institucione të akredituara nga organizmi kombëtar i akreditimit DPA, ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë

Argumentimi: Kjo kërkesë është vendosur sipas përcaktimit të bërë në mbështetje të VKM-së Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik, i ndryshuar, neni 40, pika 6, gërma c) ku cilësohet se:

Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si:

c) dëshmi për rezultatet e testimeve zyrtare, të lëshuara nga institucione të autorizuar, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike.

2.3.4 Operatori ekonomik duhet të paraqesë autorizim/et e prodhues/ve ose distributor/ve të autorizuar (në këtë rast duhet të provohet lidhja midis prodhuesit dhe distributorit nëpërmjet një autorizimi mes tyre) për të gjitha mallrat objekt prokurimi për të cilat nuk është vetë prodhues. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit dhe/ose distributorit të autorizuar si: telefon, fax, email, ëbsite, kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij.

Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë ku të deklarojë prodhuesit e të gjitha mallrave objekt prokurimi me të dhënat e kontaktit.

Argumentimi: Ky kriter është vendosur në përputhje me pikën 4, të nenit 77 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe pikën 8, të nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Autorizimi i prodhuesit është një dokument i rëndësishëm, pasi përveçse tregon origjinën e mallrave që kërkohen në procedurë, na garanton se ofertuesi është i autorizuar për ofrimin tek AK të këtyre mallrave. Autoriteti kontraktor, duke qenë se është përfituesi direkt i kontratës objekt prokurimi, është në të drejtën e tij të garantohet për besueshmërinë, cilësinë dhe kapacitetet e operatorëve ekonomikë ofertues. Në këtë kontekst, është domosdoshmërisht në dobi të përfituesve finale dhe produkteve/shërbimeve më cilësore, pra garanci për zbatimin me rigorozitet të furnizimit të mallit. Në këtë mënyrë provohet dhe aftësia reale e operatorit ekonomik për të realizuar kontratën në cilësi, sasi e kohë. Kjo garanci lidhet njëkohësisht edhe me treguesit cilësorë të mallrave që kërkohen të blihen e që janë prodhuar në standardet apo prodhues të zyrtarizuar. Ky kriter është jo diskriminues, është në përputhje me natyrën dhe përmasat e kontratës dhe lidhet drejtpërdrejtë me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë e OE ofertues për aftësitë teknike. Kjo kërkesë i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e mundësisë së OE-se për përmbushjen me sukses të kontratës. Kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale etj., reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka

në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

2.3.6 Një punësim mesatar i të paktën **7 (shtatë)** personave, të cilët duhet të figurojnë në listpagesat e shoqërisë minimumi për 3 (tre) muajt e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave vërtetuar me:

- a. Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore për 3 (tre) muajt e fundit të deklaruar.
- b. Listpagesat e punonjësve të konfirmuara nga autoritetet përkatëse sipas formatit që kërkohej nga legjislacioni në fuqi për 3 (tre) muajt e fundit të deklaruar, shoqëruar me formularët e deklarimit të pagesave për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore.

Shënim: ***Kriteri 2.3.6 konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës Nr.9. “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari dorëzimin e dokumentave provuese. Këto dokumenta duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin.

Argumentimi: Kërkesa është hartuar në përputhje me VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik, Neni 40 “Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave”, pika 5 “Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

a) licencat profesionale për prodhimin dhe ose furnizimin e mallrave, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe /ose

b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose

c) fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit...”, si dhe pika 8 “Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës”.

Rrjedhimisht mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin dokumentacion lidhur me këto kërkesa. Në këtë kontekst, referuar natyrës, vlerës së kontratës dhe objektit të prokuruar autoriteti kontraktor me anë të kërkesës së tij si me lart, e cila është vendosur në përputhje me specifikimet teknike për këtë procedurë, kërkon të garantohej për besueshmërinë, cilësinë dhe kapacitetet e operatorëve ekonomikë ofertues. Ky kriter lidhet gjithashtu me kapacitetet teknike dhe aftësitë profesionale të operatorëve.

Objekti i procedurës së prokurimit “Uniforma dhe veshje speciale” përfshin në vetvete edhe procesin e prodhimit të uniformës së MZSH-së, Shërbimit Zjarrfikës, pra përmban në vetvete elemente shërbimi për të cilën është e nevojshme që nga ofertuesit e mundshëm ekonomike të disponohet edhe një staf i cili të bëjë të mundur realizimin me sukses të këtij procesi për realizimin e uniformës së punonjësit të shërbimit zjarrfikës me anë të së cilës ata përfaqësojnë institucionin e Bashkisë Tiranë. Specialistët/ punonjësit e kërkuar janë të nevojshëm për procesin e prodhimit/ qepjeve apo modifikimeve në rast se do të jetë e nevojshme të mallrave objekt prokurimi.

Kërkesa nëpërmjet paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës përkatëse të DST dhe dokumentacioni i kërkuar do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar, i pari, referuar Nenit 26, pika 1, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ku parashikohet se, “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla”, si dhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, në lidhje me momentin e paraqitjes së dokumentacionit dëshmues për kërkesat që përfshihen në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, ku parashikohet që, “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit paraprak dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese

të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.”.

2.3.7 Ofertuesi duhet të paraqesë certifikatë OEKO-TEX “ose ekuivalente” (të vlefshme), për tekstilet të prodhuesit të lëndës së parë, për tekstilet e produkteve të të gjitha veshjeve të punës. Në rastin kur lëndët e para sigurohen nga prodhues të ndryshëm, certifikata ose dokumenti ekuivalent me të, duhet të paraqitet për të gjithë prodhuesit. Për këtë OE pjesëmarrës duhet të paraqesë një autorizim nga prodhuesi i lëndës së parë ku të bëhet lidhja midis prodhuesit dhe OE/distributorit të autorizuar.

Argumentimi: Ky kriter u vendos në përputhje me parashikimin e nenit 36 dhe nenit 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe nenit 40 dhe nenit 44, të VKM-se Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit. Referuar specifikimeve teknike të kësaj procedure prokurimi, specialistet e fushës gjykojnë se është e domosdoshme paraqitja e certifikatës OEKO-TEX, pasi lënda e parë e prodhuar nga subjekte të certifikuara sipas këtij standarti garanton se lënda e parë e përdorur është e padëmshme në aspektin ekologjik njerëzor, jep siguri pra nuk mbart substance të dëmshme për shëndetin e njeriut.

STANDARD 100 nga OEKO-TEX® është një nga etiketat më të njohura në botë për tekstilet e testuar për substanca të dëmshme. Ai garanton besimin e klientit dhe sigurinë e lartë të produktit.

Nëse një artikull tekstili mban etiketën STANDARD 100, konfirmon se çdo përbërës i këtij artikulli, d.m.th. çdo fije, buton dhe pajisje të tjera, është testuar për substanca të dëmshme dhe se artikulli është i padëmshëm për shëndetin e njeriut. Testi kryhet nga institutet partnere të pavarura OEKO-TEX® në bazë të katalogut të gjerë të kritereve OEKO-TEX®.

2.3.8 Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë se merr përsipër me anë të mjeteve të tij të bëjë furnizimin e mallit objekt prokurimi në adresën e autoritetit kontraktor me shpenzimet e tij.

Argumentimi: Kjo kërkesë është vendosur sipas përcaktimit të bërë në mbështetje të nenit 77 pika 1 “Për prokurimin publik” ku parashikohet re. “Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jene proporcionale me objektin e kontrates”. Kjo është një kërkesë e domosdoshme për të vërtetuar përputhshmërinë e specifikimeve teknike të pajisjeve të ofertuara me specifikimet teknike të hartuara nga autoriteti kontraktor (grupi i punës), për këto produkte.

2.3.9 Operatorët ekonomik ofertues, duhet të paraqesë të paketuara mostra për artikujt objekt prokurimi, si më poshtë:

- a) nga një mostër fizike për objektet e uniformës (produkt të gatshëm) që do të prokurohen që përfshin të gjitha detajet, llojin e materialit dhe pjesëve përbërëse të tyre, punimin dhe përmasat e caktuara në specifikimet teknike.
- b) Mostrat do të paraqiten në datën dhe orën e hapjes së ofertave pranë Autoritetit Kontraktor Drejtoria e Prokurimeve, Bashkia Tiranë, me adresë: Sheshi Skënderbej, Nd. 2”, Tiranë.
- c) Mostrat e paraqitura duhet të kenë një etiketë, e cila të përmbajë: mostër “emri i artikullit”, Objektin e Porcedurës/Lotin për të cilin oferton, datën e zhvillimit të tenderit, emrin e prodhuesit/ofertuesit, nënshkrimin dhe vulën e operatorit ekonomik, të identifikueshme me numrin rendor përkatës në etiketë (sipas emërimit të materialeve sipas tabelës, referuar

shtojcës nr. 7 për artikujt: Kostum uniforme (xhaketë, pantallona, këmbishë, kravatë, kapele, këpucë), atlete.

- d) Autoriteti Kontraktor ka të drejtën e kontrollit të mostrave të sjella me përputhshmerinë e specifikimeve të kërkuara dhe të kryejë analizat e nevojshme laboratorike nëse do të shihet e arsyeshme

Mosparaqitja e mostrave sipas kërkesave të mësipërme përbën kusht s'kualifikimi për vazhdimin e procedurave.

Argumentimi: Kjo kërkesë është vendosur sipas përcaktimit të bërë në mbështetje të VKM-së Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik, neni 40, pika 6, gërma a) ku cilësohet se: Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si:

a) Mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Në këtë rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të argumentojë kërkesën për mostrat. Mostrat duhet të trajtohen si informacion konfidencial 39 tregtar dhe duhet të jenë në kontroll të autoritetit/entit kontraktor. Në rastin e procedurave të zhvilluara me mjete elektronike, autoriteti ose enti kontraktor përcakton qartë procedurën për dorëzimin e mostrave, duke garantuar aksesin e çdo operatori të interesuar si dhe konfidencialitetin për pjesëmarrjen në proces. Mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve, pas nënshkrimit të kontratës ose marrëveshjes kuadër, me kusht që kontrata në fjalë ose marrëveshja kuadër të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit; dhe/ose b) fotografitë apo katalogët teknikë; dhe/ose c) dëshmi për rezultatet e testimeve zyrtare, të lëshuara nga institucione të autorizuar, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike.

Vendosja e këtij kriteri, referuar edhe legjislacionit në fuqi i shërben autoritetit kontraktor për të vlerësuar nëse një operator ekonomik ka kapacitete për të ofruar produktin e kërkuar si dhe për të verifikuar përmbushjen e specifikimeve teknike të mallrave objekt prokurimi., lidhur me të gjitha detajet, llojin e materialit dhe pjesëve të tyre, punimin dhe përmasat e caktuara në specifikimet teknike. Nëpërmjet mostarve të dorëzuara, Autoriteti Kontraktor mund të kryej kontrollin e mostrave të sjella me përputhshmerinë e specifikimeve të kërkuara dhe të kryejë analizat e nevojshme laboratorike nëse do e shihet e arsyeshme.

Shënim: 1. OE duhet të mbajnë në konsideratë përcaktimet ligjore, referuar Nenit 26, pika 1, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ku parashikohet se, “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla”, si dhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, në lidhje me momentin e paraqitjes së dokumentacionit dëshmuar për kërkesat që përfshihen në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, ku parashikohet që, “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.”.

- Mosparaqitja e dokumentacionit provues, do të jetë kusht s'kualifikimi.
- Autoriteti Kontraktor do të bëjë verifikimin e dokumentacionit në përputhje me vetedeklarimin e bërë gjatë fazës së ofertimit. Konstatimi i mospërputhjeve midis Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit dhe dokumentacionit të dorëzuar përbën kusht s'kualifikimi.

2. Referuar nenit 82, pika 4 e ligjit Nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin publik” , i ndryshuar, “Në rastin e operatorëve ekonomikë të huaj, dokumentet duhet të paraqiten në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për njohjen e dokumentacionit. Në raste të dokumenteve që nuk lëshohen në vendin e origjinës, ky fakt duhet të provohet prej operatorëve ekonomikë”, si dhe Nenit 26, pika 1, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, “Operatorët ekonomikë të

huaj duhet të paraqesin dokumentet në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për njohjen e dokumentacionit të lëshuar në një shtet të huaj. Për dokumentet që nuk lëshohen në vendin e origjinës, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë këtë fakt, përndryshe dokumentacioni do të konsiderohet i paparaqitur

3. “Oferta, si dhe të gjitha korrespondencat dhe dokumentet në lidhje me procedurën e prokurimit do të paraqiten në gjuhën/gjuhët e specifikuar në njoftimin e kontratës. Dokumentet mbështetëse dhe literatura e printuar që janë pjesë e Ofertës mund të jenë në një gjuhë tjetër me kusht që ato të shoqërohen nga një përkthim zyrtar i fragmenteve përkatëse në gjuhën e specifikuar në njoftim.”

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente me të dhëna të rreme ose të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike:

Specifikimet teknike janë hartuar nga struktura të specializuara/ Grup pune për objektin që prokurohet, i ngritur me Urdhër të Titullarit për hartimin e specifikimeve teknike/ termave të referencave për procedurën me objekt **“Blerje uniforma dhe veshje të tjera speciale”**, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 1, 2 dhe 3, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, **“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.**

Argumentimi, sipas materialit të përgatitur nga struktura e posaçme:

Në mbështetje të nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1/1.1, shkronja “d”, dhe nenit 64, shkronja “a” të Ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 për “Vetëqeverisjen Vendore” (i ndryshuar); Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 për “Menaxhimin financiar dhe kontrollin” (i ndryshuar); nenit 36 të ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar); nenit 76 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar); V.K.B-së Nr. 131 dt 18.12.2024 “Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2025-2027 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë së Tiranës për vitin 2025”; grupi i punës hartoi specifikimet teknike për realizimin e objektit: **“Blerje uniforma dhe veshje të tjera speciale”**, duke përcaktuar qartë kërkesat e Autoritetit Kontraktor. Grupi i punës i përbërë nga specialistë të fushës, i ngritur urdhër të Titullarit të AK Bashkia Tiranë, në zbatim të detyrave të përcaktuara në këtë urdhër, pas identifikimit të nevojave që kanë punonjësit e policisë, përgatiti specifikimet teknike dhe relacionin prezantues për realizimin e investimit.

Specifikimi i parametrave teknik, materialeve etj:

Termat e referencës dhe kërkesat funksionale/ specifikimet teknike hartuar nga struktura të specializuara/ Grup pune për objektin që prokurohet, i ngritur me Urdhër të Titullarit për hartimin e specifikimeve teknike/ termave të referencave, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, **“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”**(I ndryshuar), për përmblidhjen e qëllimit dhe rezultateve që pritet të arrihen nga Autoriteti Kontraktor, si më poshtë:
Qëllimi i këtij investimi është kompletimi me uniforma për policinë bashkiake.

Shënim: Autoriteti Kontraktor menjëherë pas lidhjes së Kontratës me Operatorin ekonomik të shpallur fitues, do të japë përmasat që duhen për punonjësit e policisë. Operatori ekonomik mban përgjegjësi dhe garanci për produktin e ofruar. Ndalohet shumëfishimi dhe realizimi i modeleve e ngjyrave të tyre për përdorues të institucioneve apo subjekteve të tjera që trajtohen me uniformë, të cilat nuk kanë të njëjtin

mision dhe detyre.

Mostrat e sjella nga prodhuesi e të vlerësuara nga përdoruesi (porositësi), të depozituara sipas përcaktimeve, do të shërbejnë si bazë për prodhim.

Argumentimi: Specifikimet teknike të mallit objekt prokurimi janë hartuar duke u diktuar nga nevoja për veshje me uniforma dhe elemente të tjerë sigurie sipas standarteve të miratuara dhe unifikuara për punonjësit e policisë dhe që janë shumë të rëndësishme gjatë punës së tyre. Specifikimet teknike shprehin tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe në përputhje të plotë me funksionet e kërkuara nga Autoriteti.

Sa më sipër, specifikimet teknike, janë në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Në specifikimet teknike të secilit prej artikujve pjesë përbërëse e uniformës përkufizohen karakteristikat e produktit dhe mënyrës së prodhimit të tyre, siç janë niveli i cilësisë, përshkrim i të gjitha kushteve që duhet të plotësojë produkti i prodhuar, duke përfshirë edhe vlerësim të përputhshmërisë së lëndës së parë të përdorur dhe produktit final, forma dhe përmbajtja, niveli i sigurisë dhe dimensione, përfshirë edhe kërkesat relevante për produktin në raport me simbolet, testimet dhe metodat për testim, paketimin, shënimin dhe etiketimin, si dhe udhëzime për përdorim, llojet e materialit, ngjyrës, vlerat e qëndrueshmërisë së ngjyrës, përmasat etj procese dhe metodat të domosdoshme për prodhimin e tyre në secilën fazë, në mënyrë që operatorët ekonomikë të interesuar, të kenë informacion të plotë mbi prodhimin e produktit dhe të kenë mundësi të përmbushin kushtet e kriteret sipas specifikimeve të hartuara nga AK.

Këto modele pjesë e uniformës janë parashikuar të kenë kohëzgjatje të caktuar sipas normave të harxhimit të uniformave dhe sipas të njëjtit standard me veshjet ekzistuese në përdorim. Veshjet e uniformës dhe pjesët përbërëse të saj, përfshirë aksesorët pjesë e pandashme e pamjes së uniformës, duhet të jenë detyrimisht sipas specifikimeve të kërkuara, në mënyrë që punonjësit e policisë të kenë prezencë dinjitoze sipas standartit të miratuar. Këpucët duhet të jenë detyrimisht sipas specifikimeve të kërkuara në mënyrë që punonjësit gjatë orarit të punës të jenë komode dhe të rehatshme për shkak të përditshmërisë së punës që kanë në terren.

III. Mbështetja në kapacitetet e subjekteve të tjera:

Ofertuesve nuk u lejohet të mbështeten në kapacitetet e operatorëve të tjerë për plotësimin e kërkesave për kualifikim si më poshtë vijon:

- Përvoja e suksesshme në kontrata të mëparshme, kërkuar sipas pikës 2.3.1 të Kapacitetit teknik të KVK, të shtojcës 8, të DST;
- Certifikata ISO 9001 kerkuar sipas pikës 2.3.2 dhe Certifikata sipas Direktivës 2016/425/EU kerkuar sipas pikës 2.3.5 të Kapacitetit Teknik te KVK, të shtojcës 8, të DST
- Për certifikatë OEKO-TEX “ose ekuivalente” (të vlefshme), për tekstilet të prodhuesit të lëndës së parë, për tekstilet e produkteve të të gjitha veshjeve të punës. Në rastin kur lëndët e para sigurohen nga prodhues të ndryshëm, certifikata ose dokumenti ekuivalent me të, duhet të paraqitet për të gjithë prodhuesit, kerkuar te pika 2.3.7 te Kapacitetit teknik te KVK, të shtojcës 8, të DST

Ndalimi i mbështetjes ne përvoja e suksesshme në kontrata të mëparshme, kërkuar sipas pikës 2.3.1. , kriteri për përmbushjen e përvojës së mëparshme , i shërben Autoritetit Kontraktor si garanci se kontrata do të përmbushet në cilësi dhe brenda afateve të përcaktuara në projektin përkatës dhe preventivin e punimeve ndërtimore. Mbështetja në kapacitetet e subjekteve të tjera për përvojën e mëparshme nuk duhet të lejohet sepse subjekti mbështetës me dokumentacion për vërtetimin e përvojës së ngjashme nuk mund të vendosë në dispozicion asnjë burim konkret për realizimin e pjesës përkatëse të kontratës. Duke qenë se nuk mund të ketë një angazhim të qartë dhe konkret, mbështetja në përvojën e ngjashme të një subjekti tjetër do të jetë vetëm formale dhe nuk garanton në vetvete përmbushjen me sukses të objektit të prokurimit. Nëpërmjet këtij kriteri Autoriteti Kontraktor merr garancinë se operatori ekonomik ka aftësinë e nevojshme për ekzekutimin e kontratës, e cila do të vërtetohet nëpërmjet dokumenteve si formular vlerësimi, akt kolaudimi,

certifikatë e marrjes në dorëzim etj. Nëse kjo përvojë plotësohet përmes kapaciteteve të një subjekti mbështetës, kontrata do të ekzekutohej nga një operator i cili nuk disponon vetë eksperiencën e nevojshme për realizimin e saj. Në këtë mënyrë çënohet siguria dhe garancia që kërkohet për përmbushjen me sukses të kontratës. Duke qenë se përvoja e mëparshme e ngjashme lidhet ngushtësisht me operatorin ekonomik që do të realizojë punimet dhe me aftësinë e tij për të përmbushur detyrimet kontraktore, legjislacioni i prokurimit publik ka parashikuar dhe rastet kur një operator ekonomik nuk i plotëson i vetëm kriteret e kualifikimit, duke i dhënë mundësinë të marrë pjesë në procedurë nëpërmjet bashkimit të operatorëve ekonomikë. Në këtë rast, secili anëtar i bashkimit merr përsipër realizimin e një pjesë të caktuar të kontratës, në përputhje me përqindjen dhe natyrën e pjesëmarrjes së përcaktuar në aktmarrëveshjen e bashkëpunimit, ndërsa kapacitetet teknike, profesionale dhe përvoja e mëparshme vihen në funksion të drejtpërdrejtë të realizimit të kontratës nga vetë subjektet që i disponojnë ato.

Ndalimi i mbështetjes për Certifikatat ISO kërkuar sipas pikës 2.3.2 të KVK, të Dokumenteve të Tenderit. Disponimi i certifikimeve ISO lidhen drejtpërdrejt me shoqërinë, së cilës i është lëshuar certifikata ISO. Certifikatat ISO të kërkuara në këtë procedurë prokurimi lidhen me standardet për sistemet e menaxhimit të cilësisë, standarte të lidhura ngushtësisht me subjektin, pasi lëshohen si dokumentë në emër të subjektit dhe i përkasin standarteve të cilat i ka siguruar pas auditimeve nga subjekte të licencuara për këtë qëllim. Këto certifikime përfaqësojnë standarde të brendshme organizative të operatorit ekonomik dhe nuk mund të transferohen apo të vihen në dispozicion të një operatori tjetër. Mbështetja në certifikatën ISO të një subjekti tjetër tregon që operatori ekonomik që do të zbatojë kontratën nuk është i certifikuar për standartet e kërkuara. Nëse lejohet një mbështetje e tillë, kontrata në këtë rast ekzekutohet nga një operator ekonomik, i cili nuk është vetë i certifikuar sipas standardeve të kërkuara, duke cenuar garancinë që synon të marrë autoriteti kontraktor për përmbushjen e kontratës në përputhje me kërkesat e cilësisë, të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Për sa më sipër, njësia e prokurimit vlerëson se disponimi i certifikimeve ISO është një detyrim që përcaktohet në Ligjin Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Neni 79, pika 1.

Ndalimi i mbështetjes për certifikatë OEKO-TEX “ose ekuivalente” (të vlefshme), për tekstilet të prodhuesit të lëndës së parë, për tekstilet e produkteve të të gjitha veshjeve të punës, kërkuar sipas pikës 2.3.7 të KVK, të Dokumenteve të Tenderit lidhet drejtpërdrejt me shoqërinë, së cilës i është lëshuar certifikata OEKO-TEX. Certifikata OEKO-TEX e kërkuar në këtë procedurë prokurimi lidhet me tekstilet dhe produktet që janë në kontakt me lekuren, me produktin/materialin konkret me prodhuesin dhe me fushën e certifikimit dhe jo me kapacitetin e përgjithshëm të një operatori ekonomik, standarte të lidhura ngushtësisht me subjektin, pasi lëshohen si dokumentë në emër të subjektit dhe i përkasin standarteve të cilat i ka siguruar pas auditimeve nga subjekte të licencuara për këtë qëllim. Këto certifikime përfaqësojnë standarde të brendshme organizative të operatorit ekonomik dhe nuk mund të transferohen apo të vihen në dispozicion të një operatori tjetër. Mbështetja në certifikatën OEKO-TEX të një subjekti tjetër tregon që operatori ekonomik që do të zbatojë kontratën nuk është i certifikuar për standartet e kërkuara. Nëse lejohet një mbështetje e tillë, kontrata në këtë rast ekzekutohet nga një operator ekonomik, i cili nuk është vetë i certifikuar sipas standardeve të kërkuara, duke cenuar garancinë që synon të marrë autoriteti kontraktor për përmbushjen e kontratës në përputhje me kërkesat e cilësisë, të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Për sa më sipër, njësia e prokurimit vlerëson se disponimi i certifikimeve OEKO-TEX është një detyrim që përcaktohet në Ligjin Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Neni 79, pika 1.

Sa më sipër, hartimi i kërkesave për kualifikim, që lidhen me kapacitetin teknik, specifikimet teknike/ termat e referencës, dhe çdo informacion tjetër specifik i nevojshëm, janë hartuar nga specialisti/ specialistët e fushës, anëtar të njësisë së prokurimit.

Për të krijuar dosjen e tenderit në sistemin e prokurimit elektronik të APP dhe për të ngarkuar të gjithë dokumentacionin e procedurës së prokurimit me objekt **“Blerje uniforma dhe veshje të tjera speciale”**

Njësia e Prokurimit autorizoi personin përgjegjës për prokurim.

NJËSIA E PROKURIMIT

Arlinda Mucaj	Personi Përgjegjës (Drejtoria e Prokurimeve)
Fioranda Ramadani	Specialist i fushës (Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse)
Enri Kraja	Specialist i fushës (Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse)